



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 18.

Prishtinë, më 15.07.2015 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, Milka Vuletić, Saša Milosavljević, Slavko Simić, Čerim Bajrami dhe Veton Berisha.

Munguan: Danush Ademi.

Emrat e pjesëmarrësve në mbledhje : përfaqësues nga OSBE-ja Lejla Selimi, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** – kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.05 / 8.06. dhe 29.06.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.05 / 8.06. dhe 29.06.2015;

Kryesuesja – konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 27.05 8.06. dhe 29.06.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;

Kryesuesja – për informim tha se në takimin e ditës së djeshme komisioni ka shqyrtuar në fomë të detajuar Projektligji nr. 05/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe ka dal me qëndrim që të ndahen mjete buxhetore për funksionalizimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe të Qendrës Historike të Prizrenit, për kompetenca të zgjeruara që ndahen për Komunën e Rahovecit dhe të Prizrenit. Nga sa u tha më lart, Komisioni i rekomandon Komisionit funksional që të miratojë amendamentin e propozuar në kuadër të Projektligjit, ndërsa Ministria e Financave të bëjë harmonizimin në kuadër të tabelave buxhetore.

Pas propozimit të lartëcekur, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin dhe Raportin me amendament të Komisionit funksional dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të Raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković